



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 728, datë 07.12.2023

PËR

VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...}, PËR VITIN 2019

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukperaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”;Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit, bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1. A Njohuritë ligjore

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile, është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi pa qenë e lidhur me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, nga e cila do të përcaktohet më pas natyra juridike e saj, e për pasojë edhe referenca relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:***

Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtari, në bazë të kategorisë së çështjes (*padi themeli ose kërkesë civile*), i kushton rëndësi të veçantë përshkrimit të detajuar dhe analitik të fakteve të çështjes, si të atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe të fakteve që lidhen me themelin, duke i parashtruar ato respektivisht në pjesën e parë dhe të dytë të arsytimit të vendimit.

Paraqitja e rrethanave procedurale përbën pjesën hyrëse të arsytimit të vendimit, në një nënndarje të titulluar përgjithësisht “*Paraqitja e padisë dhe aspekte procedurale*”, në të cilën parashtrohet, përveç vlerësimit të gjykatës lidhur me plotësimin e parakushteve procedurale në drejtim të juridiksionit gjyqësor, kompetencës lëndore dhe tokësore, përbërjen e trupit gjykues, (*elementë të cilët analizohen në çdo vendim*) evidentohet sipas rastit ecuria procedurale e çështjes lidhur me (i) vlerësimi i gjykatës lidhur me kërkesën e palës për

saktësimin e objektit të padisë,¹ (ii) shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve dhe pa u mbajtur procesverbal,² apo (iii) lidhur me interesin e ligjshëm dhe legjitimitimin pasiv.³ Në një nga çështjet civile objekt shqyrtimi, referuar natyrës së vendimit, gjyqtari është ndalur vetëm në pasqyrimin dhe analizën e fakteve me natyrë procedurale, atyre lidhur me rastin e heqjes dorë nga e drejta e padisë, si atribut themelor vetëm i palës paditëse dhe pasojat e kësaj kërkesë, përcaktuar kjo nga natyra e vendimit gjyqësor, i cili është vendim për rrëzimin e padisë, për shkak të heqjes dorë nga krejtësisht nga e drejta e padisë.⁴

Pas përshkimit dhe analizës së rrethanave me karakter procedural, gjyqtari parashton rrethanat e faktit objekt gjykimi, në një nënndarje të titulluar përgjithësisht “*Rrethanat e çështjes, faktet dhe provat*” duke i parashtruar ato në mënyrë të qartë, në një rend logjik dhe kronologjik dhe duke integruar në përmbajtje të faktit, provat përkatëse të analizuara në raport me njëra-tjetrën. Në secilin vendim burim vlerësimi, faktet e çështjes janë përshkruar dhe analizuar në mënyrë tepër të detajuar dhe të plotë, duke u shoqëruar në çdo rast me paraqitjen dhe analizën e provave të administruara në gjykim, në mbështetje të konkluzioneve të gjyqtarit lidhur me provueshmërinë e fakteve thelbësore të çështjes.

Gjyqtari i kushton rëndësi nxjerrjes së faktit juridik civil, fakt ky, që nuk i referohet vetëm asaj çfarë kanë prezantuar palët në pretendimet apo prapësimet e tyre, por në përputhje me provat e administruara gjatë gjykimit. Gjithashtu, gjyqtari në nxjerrjen e faktit juridik, bazohet jo vetëm në provat e paraqitura nga ana e palëve ndërgjyqëse, por edhe provave të marra kryesisht, apo në kryerjen e akteve të ekspertimeve në ato raste kur për zgjidhjen sa më drejtë të çështjes nevojiten njohuri të posaçme.⁵ Në të gjitha vendimet e analizuara konstatohet se gjyqtari tregon kujdesin e duhur, që në mbështetje edhe të nenit 16 të K.Pr.Civile të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve (*i ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike*) që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi.

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtari identifikon dhe përcakton qartë dhe në mënyrë të shprehur natyrën e çështjes objekt shqyrtimi. Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarit, duke e cituar atë në pjesën hyrëse dhe përshkruese-arsyetuese të vendimit, e në disa raste, si pasojë e një analize ligjore të shkakut dhe objektit të padisë,⁶ pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj, duke cituar dhe analizuar për këtë qëllim edhe dispozitat procedurale, në lidhje me kompetencën lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e çështjes.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm: Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë aspekt, referuar vendimeve burim vlerësimi, evidentohet se gjyqtari ka identifikuar dhe përcaktuar ligjin e zbatueshëm, duke referuar ose cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural dhe material, të cilat merren në

¹Vendimi nr.1630, datë 05.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²Vendimi nr.5045, datë 10.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³Vendimi nr.8868, datë 27.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁴Vendimi nr.2953, datë 24.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁵Vendimi nr.4538, datë 24.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁶Vendimet nr.4538, datë 24.06.2019, nr.8868, datë 27.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

analizë në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të karakterit procedural, apo zgjidhjen në themel të çështjes.

Sa i përket ligjit procedural gjyqtari identifikon dhe referon në pjesën arsyetuese të vendimit, dispozitat procedurale, si më poshtë:

- nenet 36, 41, 42, 43, 45, 47/1, 48, 49, 50, 52, 399/1, 399/4, 399/6, 510/2 pika “e”, 511/2 pika “ç” dhe 610 të K.Pr.Civile, lidhur me përcaktimin e juridiksionit gjyqësor, kompetencës lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve, referuar objektit të tyre (*çështje me objekt njohje pronar me parashkrim fitues, konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm të procedurës përmbartimore të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, dëmshpërblim që rrjedh nga zgjidhja e marrëdhënies së punës, përmbushje e detyrimeve që rrjedhin nga fatura tatimore, kundërshtim veprimesh përmbartimore, lëshim urdhri ekzekutimi, etj.*)
- nenet 71, 72, 73 të K.Pr.Civile lidhur me ekzistencën e shkaqeve të papajtueshmërisë ose përjashtimit të gjyqtarit;⁷
- nenet 2, 5, 16/1, 17, 9, 180 të K.Pr.Civile lidhur me identifikimin e shkakut ligjor të padisë dhe kërkimeve të paditësit; nenin 16/1, 6, 17, 28 të K.Pr.Civile lidhur me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi të detyrueshme për t’u zbatuar; shprehjen e gjykatës për gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet; dhënien mundësi palëve që të japin shpjegime nga pikëpamja e së drejtës që ajo e çmon të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe lidhur me dhënien mundësi palëve që të shprehen për të gjitha kërkesat që parashtrohen në padi;⁸
- nenet 32, 399/1 e vijues dhe 510 e vijues të K.Pr.Civile lidhur me legjitimimin aktiv të palës së interesuar kreditore për t’iu drejtuar gjykatës me kërkesë për konstatimin e shkeljes së procesit të rregullt ligjor; nenin 399/2, pika 1, germa “c” të K.Pr.Civile, lidhur me afatin e arsyeshëm në procedurën e ekzekutimit të një vendimi civil dhe momentin e fillimit të llogaritjes së këtij afat; nenin 615/dh të K.Pr.Civile (ligji i kohës së këtij veprimi procedural) në lidhje me pezullimin e ekzekutimit për shkak të mosparaqitjes së kreditorit; nenet 128 e vijues, 144 të K.Pr.Civile lidhur me detyrimin ligjor të përmbartuesit që çdo veprim dhe akt të fazës së ekzekutimit t’ua komunikojë palëve të procesit të ekzekutimit (kreditorit, debitorëve);⁹
- nenin 12 të K.Pr.Civile lidhur me barrën e provës; nenin 9 të Ligjit nr. 10221 datë 14.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”* lidhur me barrën e provës punëmarrësit për të paraqitur faktet dhe provat mbi të cilat mbështet pretendimet e tij për trajtim të pabarabartë; nenin 317 të K.Pr.Civile lidhur me dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm; nenin 444 të K.Pr.Civile lidhur me afatin e ankimit dhe momentin e fillimit të këtij afati;¹⁰
- nenet 2, 5, 185 dhe 201/1 të K.Pr.Civile lidhur me disponibilitetin e paditësit për të pakësuar objektin e padisë; nenin 32 të K.Pr.Civile lidhur me legjitimimin aktiv dhe kushtet formale procedurale për ngritjen e padisë;
- nenin 609 të K.Pr.Civile lidhur me kundërshtimin e masës së detyrimit apo vlefshmërinë e titullit ekzekutiv; nenin 517 të K.Pr.Civile lidhur me lajmërimin për ekzekutim vullnetar; nenin 10 të ligjit nr. 114/2016, i cili lidhet me ndryshimet dhe shtesat në K.Pr.Civile; nenet 31/1, 117, 154, 156, 442/a të K.Pr.Civile lidhur me mjetet procedurale

⁷Këto dispozita referon në të gjitha vendimet burim vlerësimi

⁸Vendimet nr.4538, datë 24.06.2019, nr.5045, datë 10.07.2019, nr.8868, datë 27.12.2019, nr.1630, datë 05.03.201, nr.6871, datë 17.10.2019 dhe nr.3597, datë 20.05.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁹Vendimi nr.5045, datë 10.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁰Vendimi nr.8868, datë 27.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

që vënë në lëvizje gjykatën; nenin 519 të K.Pr.Civile lidhur me mospërmbushjen vullnetare;¹¹

- nenin 106 të K.Pr.Civile, lidhur me përcaktimin e detyrimit për pagimin e shpenzimeve gjyqësore.

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, rezulton se gjyqtari identifikon dhe/ose citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në shmangien e citimit apo të listimit të dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk referojnë drejtpërdrejt në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Në vendimet gjyqësore objekt vlerësimi (*me objekt njohje pronar me parashkrim fitues, përmbushje detyrimi, kundërshtim veprimesh përmbartimore, dëmtshpërblim për marrëdhënie pune, etj.*) gjyqtari identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar dispozitave materiale të Kodit Civil, Kodit të Punës, ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme, kryesisht në lidhje me:

- *Fitimin e pronësisë me parashkrim fitues*, ku gjyqtari identifikon si ligj të zbatueshëm nenet 1162, 1168 të K.Civil, lidhur me ligjin material të aplikueshëm; nenet 79, 83, 149, 162, 163, 164, 168, 169, 170, 171, 191, 193, 304-309 të K.Civil lidhur me kuptimin e veprimit juridik, formën e veprimit juridik për kalimin e pronësisë, tagrat e pronarit, mënyrat e fitimit të pronësisë, fitimi i pronësisë me anë të kontratës, fitimi i pronësisë me parashkrim fitues me titull, fitimi i pronësisë me parashkrim fitues pa titull, të paditurit në padinë e parashkrimit fitues, pezullimi e ndërprerja e parashkrimit fitues, humbja e së drejtës së pronësisë me anë të heqjes dorë, regjistrimi i pasurive të paluajtshme, posedimi, llojet e posedimit, posedimi me mirëbesim dhe me keqbesim, prezumime mbi posedimin, mënyrat e fitimit të posedimit. Gjithashtu, identifikohet neni 44 i ligjit nr. 33/2012 “*Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme*”; nenet 1, 2, 4, 9, 13, 14 të ligjit nr. 8743 datë 22.02.2001 “*Për pronat e paluajtshme të shtetit*” lidhur me llojet e pronave të paluajtshme të shtetit, përkufizimet, prona jopublike të paluajtshme të shtetit, transferimi dhe regjistrimi përfundimtar, funksionet e Këshillit të Ministrave; nenet 9, 17 të ligjit nr. 8744 datë 22.02.2001 “*Për transferimin e pronave publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*”; VKM nr. 500 datë 14.08.2001; VKM nr. 650 datë 31.07.2013 “*Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit, pjesa e tretë, e katërt dhe e pestë të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Tiranë, të Qarkut Tiranë*”; ligji nr. 9482 datë 03.04.2006 “*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*”.¹²
- *Shpërblimin e dëmit që buron nga zgjidhja e marrëdhënies së punës*, gjyqtari identifikon dhe citon dispozitat ligjore relevante, nenet 140/1, 141, 143/1, 144, 145, 146 dhe 148 të K.Punës lidhur me kontratën e punës, afatin e saj, përfundimin para afatit, afati i njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, procedura për zgjidhjen e kontratës së punës, shpërblimi për vjetërsi, shkaqet abuzive të zgjidhjes së kontratës së punës, pushimi kolektiv; nenet 159, 169, 171 e vijim të K.Punës lidhur me kontratën kolektive të punës; nenin 11 të K.Punës lidhur me hierarkinë dhe përparësinë e normave të së drejtës së punës; nenin 21 të K.Punës lidhur me shpërblimin në formën e pagës bruto; nenet 153-158 të K.Punës lidhur me përfundimin në formën e jashtëzakonshme të kontratës së punës; nenet 23, 25, 26, 27, 28 e vijues të K.Punës lidhur me detyrimet e të drejtat e punëdhënësit dhe punëmarrësit; nenin 149 të K.Punës lidhur me përfundimin e kontratës me afat të caktuar në fund të afatit të vetë kontratës; nenin 144 të K.Punës lidhur me zgjidhjen e jashtëzakonshme/me efekt të menjëhershëm.¹³
- *Lidhur me padinë e detyrimit për kthimin e shumës dhe shpërblimin e dëmit*, gjyqtari identifikon si ligj të zbatueshëm nenet 419, 420, 455, 463, 473, 476, 481, 486, 690, 698 të K.Civil lidhur me

¹¹Vendimi nr.3597, datë 20.05.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹²Vendimi nr.4538, datë 24.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹³Vendimi nr.8868, datë 27.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

kuptimin e detyrimit, lindjen e detyrimeve, afatin e ekzekutimit të detyrimit, mënyrën e ekzekutimit, vonesa e debitorit, fitimi i munguar, parimin se kontrata ka forcën e ligjit për palët, zgjidhjen e kontratës; ligjin nr. 115, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrative – territorial të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me të detyruarin.¹⁴

- *Në kërkesën për lëshimin e urdhrimit të ekzekutimit*, krahas neneve 510 dhe 511 të K.Pr.Civile, lidhur me titujt ekzekutiv, referohet edhe nenet 28, 30, 31, 32 të ligjit nr. 9396/2005 “Për qiranë financiare”, lidhur me zgjidhjen e kontratës së qirasë financiare nga qiradhënësi, e drejta e rimarrjes së sendit, rimarrja jashtëgjyqësore e sendit; procedura e rimarrjes së sendit me anë të sekuestrimit; nenet 6, 12, 13 të ligjit nr. 9369/2005 lidhur me subjektet që mund të licensohen si ushtrues të veprimtarisë së qirasë financiare dhe nenet 11, 12 lidhur me formën dhe kushtet bazë të kontratës,¹⁵ etj.

Krahas dispozitave të Kodit Civil, Kodit të Punës dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtari ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe dispozita të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës:

- nenet 11, 41, 42 të Kushtetutës lidhur me ekonominë e tregut dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike, të drejtën e pronës dhe të drejtën për proces të rregullt, si dhe nenin 1 Protokollit 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me të drejtën e pronës;¹⁶
- nenin 42 të Kushtetutës dhe neni 6 të KEDNJ lidhur me parimin e procesit të rregullt ligjor, Konventën nr. 158 të ONP “Për ndalimin e punësimit me iniciativën e punëdhënësit” lidhur me respektimin e procedurës në raportin juridik punëdhënës – punëmarrës.¹⁷

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret. Nga ana tjetër, nuk konstatohet asnjë rast ku analiza e konfliktit të normave të ketë qenë e domosdoshme, në mbështetje të arsyetimit lidhur me zgjidhjen e çështjes.

KONKLuzioni

Në tërësi, spikat aftësia e gjyqtarit për paraqitjen dhe analizën e plotë të fakteve, si të atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecures së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore, në rastet kur elementët proceduralë lidhen në trajtimin e kërkesave të palëve, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë të detajuar, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjithashtu, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

¹⁴Vendimi nr.1630, datë 05.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁵Vendimi nr. 10213/64 regj., datë 14.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁶Vendimi nr.4538, datë 24.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁷Vendimi nr.8868, datë 27.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes

Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t’i japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

- Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*procedurale dhe materiale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen ose referohen duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes dhe në asnjë rast citimi i dispozitave nuk është i pashoqëruar me ndërthurjen e interpretimit të tyre mbi faktin konkret ose konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Konstatohet se gjyqtari kryesisht përdor interpretimin teleologjik të normës konkrete (*ratio legis-për të cilën ajo është krijuar*), por edhe sipas interpretimit literal e gramatikor, apo sistematik të normave, duke e përqsaur kuptimin e normës me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, në funksion të konkluzionit në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:

Në vendimet burim vlerësimi përgjithësisht interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se:

- Interpreton në mënyrë literale nenet 168 dhe 196 të K.Civil në lidhje me fitimin e së drejtës së pronësisë nëpërmjet parashkrimit fitues me ose pa titull, duke zbërthyer dhe analizuar në mënyrë të detajuar kushtet e kumulative që duhet të përmbushen për të qenë para kësaj mënyre të fitimit të së drejtës së pronësisë. Trajton institutin e posedimit, në interpretim teleologjik të neneve 304 e vijues të K.Civil, si i përbërë nga dy elementë: trupor dhe vullnet të subjektit. Lidhur me të parin përbën një sundim efektiv të një personi mbi një send dhe mbi të drejtat reale të tij (sendit) dhe shfaq një marrëdhënie të ngushtë të personit me këtë send duke e zotëruar apo duke e mbajtur. Për elementin e dytë duhet shpirti ose qëllimi për të poseduar, pra qëllimi për t’u sjellë si pronar i sendit. Posedimi duhet të jetë i pandërprerë, i qetë, publik, dhe të ketë vullnet ta mbajë sendin si të vetin. Provueshmëria e posedimit të vazhdueshëm, të pandërprerë dhe të qetë mund të bëhet përmes të gjitha llojeve të provave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile, të cilat në përputhje me njëra tjetrën nxjerrin në pah dhe provojnë ekzistencën e faktit të pretenduar. Interpreton në mënyrë historike parashkrimin fitues (*me titull dhe pa titull*) për të cilin interpreton nenet 44-48 të Dekretit nr. 2083, datë 06.07.1956 “Mbi pronësinë”, si dhe nga Kodi Civil i vitit 1982 (nenet 91 e 92); nenet

1168 të Kodit Civil dhe mban qëndrimin se parashkrimi fitues pa titull nuk ka qenë i parashikuar më parë, për rrjedhojë parashkrimi fitues pa titull, mund të pretendohet vetëm për posedim të qetë e të pandërprerë të sendit prej 20 vjetësh, duke filluar të ecë ky afat nga dita e hyrjes në fuqi të Kodit Civil (sipas nenit 1168 të tij, më datë 01.11.1994).¹⁸

- Interpreton nenet 12, 21 të K.Punës lidhur me kuptimin e kontratës së punës, si një kontratë e së drejtës private, sipas të cilës një person (punëmarrësi) ofron shërbimin dhe punën e tij për një subjekt tjetër (punëdhënësin) në shkëmbim të pagës, kontratë në të cilën palët përcaktojnë lirisht të drejtat dhe detyrimet, përmbajtjen e saj brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Interpreton nenin 148 të K.Punës lidhur me institutin e pushimit kolektiv nga puna duke mbajtur në konsideratë praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, duke konkluduar mbi kushte që duhet të plotësohen që të jemi përpara këtij instituti; Interpreton nenet 159 e në vijim, 169, 171 të K.Punës lidhur me kontratën kolektive të punës; Interpreton nenet 140 e 141 të K.Punës lidhur me përfundimin e kontratës me kohëzgjatje të pacaktuar kur zgjidhet nga njëra palë dhe ka përfunduar afati i njoftimit. Në këtë spektër, trajton se afati i njoftimit shërben për punëmarrësin jo thjesht dhe vetëm për t'u informuar se në një datë të ardhshme dhe të caktuar do të përfundojë marrëdhënia e punës, por edhe që punëmarrësi të ketë mundësi për të marrë masat e nevojshme që të planifikojë e të rregullojë ekonominë personale e familjare, të llogarisë një papunësi potenciale në të ardhmen duke u përpjekur të sigurojë jetesën në mënyrë të ligjshme. Pra, qëllimi është mbrojtja e pozitës së punëmarrësit dhe mbrojtjen e punëdhënësit. Interpreton nenin 146 të K.Punës lidhur me zgjidhjen e kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme ose motive abuzive, të cilat trajtohen si shteruese dhe në mënyrë sistematike nenin 9 e 15 të ligjit nr. 10221, datë 14.02.2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*" ku përcaktohet se barrën e provës për të provuar trajtim të pabarabartë e ka paditësi. Interpreton nenin 144/3 të K. Punës lidhur me procedurën për zgjidhjen e kontratës së punës, duke arsyetuar se respektimi i procedurës është moment i rëndësishëm në raportin juridik punëdhënës- punëmarrës, që duhet të jetë në përputhje me kërkesat e ligjit si në përmbajtje dhe në aspektin formal dhe kalon në disa faza (tre aktet tipike të procedurës): Njoftimi paraprak me shkrim; zhvillimi i bisedimeve; njoftimi i zgjidhjes së kontratës së punës, ku barrën e provës për t'i provuar ezaurimin e këtyre fazave, e ka punëdhënësi.¹⁹

Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale, gjyqtari i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normës, jo vetëm përsa i përket aspekteve meritore, por edhe atyre procedurale në rastin kur ngrihen çështje të procedurës, apo kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel. Konkretisht:

- Në vendimin me objekt "*Kundërshtim veprimesh përmbartimore*", gjyqtari interpreton dhe analizon në mënyrë të thelluar nenin 610 të K.Pr.Civile lidhur me mjetin procedural të mbrojtjes së debitorit në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, për të cilin mban qëndrimin se është gjykim themeli që përqendrohet mbi shqyrtimin e ligjshmërisë ose jo të veprimeve përmbartimore. Kundërshtitë lidhen me formën e aktit procedural, me përmbajtjen e aktit procedural, me mosrealizimin e rregullt të njoftimeve, nuk lidhet me themelin e titullit ekzekutiv dhe në këtë aspekt bën dallimin se kjo arrihet përmes nenit 609 të K.Pr.Civile; është garanci procedurale e barazisë së armëve të palëve ndërgjyqëse që zbatohet edhe gjatë procesit të ekzekutimit; nuk ka rëndësi emërtimi që përdoret nga subjekti "*padi, kërkesëpadi, ankim*" pasi jemi përpara një akti mbrojtje që duhet të merret në shqyrtim nga gjykata, referuar aksesit në drejtësi si pjesë e procesit të rregullt ligjor parashikuar nga neni 6 i KEDNJ, neni 42 i Kushtetutës dhe neni 4 i K.Pr.Civile.

¹⁸Vendimi nr. 4538, datë 24.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁹Vendimi nr. 8868, datë 27.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Interpreton historikisht ndryshimet procedurale në nenin 610 të K.Pr.Civile, përcaktuar në nenin 10 të ligjit nr. 114/2016 dhe bën analizë krahasimore lidhur me ndryshime thelbësore lidhur me këtë mjet të fazës përmbartimore, për emërtimin e tij (nga “padi” në “ankim”) dhe ndërgjyqësinë (përmbartuesi thirrej si i paditur) dhe pas kësaj, i udhëhequr nga jurisprudence kushtetuese mbi zbatimin e ligjit procedural në kohë, sa kohë në dispozitat kalimtare nuk parashikohet ndryshe, mban qëndrimin se ndryshimet procedurale aplikohen në rastin objekt shqyrtimi nisur nga data kur është regjistruar ankimi. Interpreton në mënyrë sistematike nenet 517 dhe 519 të K.Pr.Civile, si dhe kriteret përkatës të Titullit II të këtij Kodi dhe mban qëndrimin se njoftimi për ekzekutim vullnetar është thjesht dhe vetëm njoftimi i titullit ekzekutiv, i urdhrit të ekzekutimit, i detyrimit dhe masës që duhet të paguhet apo veprimi që duhet të kryhet, si edhe i njoftimit (paraprak) që në rast mospërmbushje vullnetare të detyrimit, do të kalohet në ekzekutim të detyrueshëm. Pra, sipas gjyqtarit, nuk kanë filluar ende veprimet përmbartimore që janë shprehje e vjeljes forcërisht të detyrimit, duke kaluar në ekzekutim të detyrueshëm.²⁰

- Në vendimin me objekt “Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm të procedurës përmbartimore të ekzekutimit të titullit ekzekutiv”, gjyqtari interpreton në mënyrë sistematike nenet 32, 399/1 e vijues dhe 510 e vijues të K.Pr.Civile lidhur me legjitimitimin aktiv të palës së interesuar ankuese/kreditore për t’iu drejtuar me kërkesë për konstatimin e shkeljes së procesit të rregullt ligjor; nenin 399/2, pika 1, shkronja “c”, si rregull afati i arsyeshëm i një procedure ekzekutimi të një vendimi civil është një vit dhe ky afat fillon të llogaritet nga momenti kur është paraqitur kërkesa për vënie në ekzekutim; nenin 615/dh të K.Pr.Civile (ligji i kohës së këtij veprimi procedural) në lidhje me pezullimin e ekzekutimit për shkak të mosparaqitjes së kreditores; nenet 128 e vijues, 144 të K.Pr.Civile lidhur me detyrimin ligjor të përmbartuesit që çdo veprim dhe akt të fazës së ekzekutimit t’ua komunikojë palëve të procesit të ekzekutimit (kreditorit, debitorëve). Interpreton dhe mban qëndrimin se kriteret që duhet të analizohen për të shqyrtuar nëse ka apo jo shkelje të së drejtës në thelb (jo thjesht kalimin e një afati në aspektin kohor mbi 1 vit që nga dita e paraqitjes së kërkesës për ekzekutim) sipas nenit 399/1 e vijues janë në harmoni me standardin e GJEDNJ për procesin e rregullt ligjor në vështrim të nenit 6/1 të KEDNJ. Interpreton nenin 83 të ligjit nr. 38/2017, i cili parashikoi në Kodin e Procedurës Civile dispozitat 399/1–399/12, si risi e ligjit procedural dhe e rendit juridik (kushtetues e ligjor) qëllimi i të cilave ka qenë përfshirja e një mekanizmi mbrojtës për palën e dëmtuar nga zvarritja tej afateve normale e të arsyeshme e një gjykimi civil (proces në zhvillim e sipër) apo e një procesi ekzekutimi për një titull ekzekutiv të caktuar, kjo në përputhje me standardin e nenit 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe me nenin 42 të Kushtetutës së RSH.²¹
- Interpreton në harmoni me njëri-tjetrin nenet 2, 5, 185, 201/1 të K.Pr.Civile si shprehje e parimit të disponibilitetit të padisë. Trajton legjitimitimin formal dhe interesin e ligjshëm, përmes interpretimit të nenit 32 të K.Pr.Civile, duke analizuar se legjitimiteti pasiv vlerësohet si një nga kushtet më të rëndësishme procedurale për faktin se është i lidhur direkt me efektet që do të ketë vendimi gjyqësor i marrë nga gjykata. Përcaktimi i saktë i ndërgjyqësisë në një proces civil ka lidhje direkte me vlefshmërinë e padisë, për të cilën

²⁰Vendimi nr. 3597, datë 20.05.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²¹Vendimi nr.5045, datë 10.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

duhet të plotësohen dy kushte: interesi i ligjshëm dhe legjitimiteti për të vepruar, të cilat pasjellin vendimin mbi themelin e saj, për ta pranuar ose rrëzuar atë.²²

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante, rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur gjerësisht jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, vendimet e GJEDNJ*), në mbështetje të argumenteve të tij në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- Vendimin unifikues nr. 3, datë 29.03.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në lidhje me objektin dhe shkakun ligjor të padisë, vendimin unifikues nr. 9, datë 09.03.2006 lidhur me formulimin e kërtimeve, sa i përket objektit të padisë; vendimin unifikues nr. 5, datë 31.05.2011 lidhur me padinë për kërkimin e sendit; vendimin nr.4, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese, i cili ka marrë në shqyrtim antikushtetutshmërinë e nenit 169 të K.Civil (parashkrim fitues pa titull) në lidhje me këtë mënyrë fitimi të pronësisë (parashkrim fitues me ose pa titull). Referon vendimet nr. 54, datë 20.02.2014 dhe nr. 262, datë 21.05.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për të mbajtur qëndrimin se toka truall në pronësi të shtetit nuk mund të jenë objekt i fitimit nëpërmjet parashkrimit fitues, pasi janë prona të paluajtshme publike të patjetërsueshme; vendimet gjyqësore të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, të tillë si vendimi nr.100/viti 2016; vendimi nr.500/viti 2015; vendimi nr.54/viti 2014; vendimi nr.262/viti 2014; vendimi nr.463/viti 2014; vendimi nr.152/viti 2012; vendimi nr.252/viti 2015; vendimi nr.360/viti 2011; vendimi nr.166/2011; vendimi nr.379/viti 2010; vendimi nr.303/viti 2009; vendimin nr.456/viti 2009; vendimi nr.214/viti 2008, në lidhje me këtë moment të posedimit (elementet *corpus/animus*) lidhur me kuptimin e formave të posedimit (për *parashkrimin fitues*, me apo pa titull, si dhe për *posedimin*), si një nga tagrat e pronësisë, kjo e fundit një nga të drejtat reale.²³
- Referon jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me procesin e ekzekutimit i cili duhet të garantohet nga procesi i rregullt dhe që duhet të jetë i plotë dhe shterues, jo vetëm i pjesshëm (*Çështja Matheus kundër Francës, GJEDNJ*); kohëzgjatja e ekzekutimit përtej afatit 5 vjeçar është konsideruar si një rast në shkellje të nenit 6/1 të KEDNJ, përderisa nuk ishte bërë asgjë në drejtim të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë e të zbatueshëm duke e bërë kështu të padobishëm (*Çështja Hornsby kundër Greqisë, Ouzounis etj.kundër Greqisë, Fouklev kundër Ukrainës, Qufaj kundër Shqipërisë, Scordino kundër Italisë*); në çështjet civile, kohëzgjatja shtrihet edhe në pjesën e ekzekutimit të vendimit sepse konflikti zgjidhet përfundimisht vetëm gjatë kësaj faze, procedurat e ekzekutimit të një vendimi janë të rëndësishme për palën (*Silva Pontes kundër Portugalisë, GJEDNJ 23 mars 1994*); natyra e rëndësia e asaj që humbet pala nga tejzgjatja e një procesi gjyqësor apo procesi ekzekutimi, pra lloji i së drejtës së cenuar (*Comingersoll kundër Portugalisë, Frydlender kundër Francës, Surmeli kundër Gjermanisë*); kriteret lidhur me kompleksitetin e çështjes (*Katte Klitche kundër Italisë, Papachelas kundër Greqisë*). Referon vendime të Gjykatës Kushtetuese ku theksohet se mosekzekutimi i vendimit gjyqësor si pjesë e cenimit të procesit të rregullt ligjor, praktikë në përputhje me vendimin e GJEDNJ datë 18.11.2004 *Qufaj kundër Shqipërisë*, pavarësisht llojit të detyrimit.²⁴
- Referon vendimin unifikues nr. 19/2007 i Gjykatës së Lartë lidhur me mënyrën sesi duhet trajtuar zgjidhja e marrëdhënies së punës, si dhe shpërblimet përkatëse; praktikën gjyqësore lidhur me pushimin kolektiv (vendimet nr. 459, datë 11.09.2014, nr. 130, datë 10.04.2014, nr. 296 datë 10.06.2015; nr. 00934/12 regj. datë 05.02.2015, nr. 445 datë 22.10.2015 të Kolegjit

²²Vendimi nr.1630, datë 05.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²³Vendimi nr. 4538, datë 24.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁴Vendimi nr. 5045, datë 10.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Civil të Gjykatës së Lartë); vendim unifikues nr. 7, datë 01.06.2011 të Kolegjeve të Gjykatës së Lartë lidhur me natyrën juridike të urdhrit që njofton zgjidhjen e kontratës së punës, i cili nuk trajtohet si një akt administrativ, por si një akt që dokumenton përfundimin e marrëdhënies së punës,²⁵ etj.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton kujdesi i përhershëm i gjyqtarit që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referohen dhe zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës, gjë që realizohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsytimit të vendimit. Gjyqtari njeh, referon dhe zbaton parimet materiale e procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- (i) parimin e procesit të rregullt ligjor në lidhje me respektimin e të drejtave procedurale të palëve ndërgjyqëse, kontradiktoritetin, disponibilitetin e padisë nga pala paditëse në përcaktim në objektin të mosmarrëveshjes, barrën e provës, fuqinë provuese të provave të administruara në gjykim;
- (ii) Parimin e prezumimit të fajësisë për debitorin palë në proces dhe njëkohësisht palë kontraktore;
- (iii) Parimin e lirisë së formës së veprimeve juridike; parimin se ligji prezumohet i njohur për të gjithë shtetasit;
- (iv) Parimin se norma procedurale civile ndjek një rrugë tjetër nga ajo materiale dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor zbatohet norma procedurale në fuqi, për aq sa nuk ka një parashikim të ndryshëm në dispozitat kalimtare, etj.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural, apo në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen. Po ashtu, në shumicën e vendimeve burim vlerësimi rezulton kujdesi i shtuar i gjyqtarit për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si dhe kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsytim dhe mbështesin argumentet e gjyqtarit lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.B Arsytimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit

- **Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtari gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuarra, në

²⁵Vendimi nr. 8868, datë 27.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës apo parimeve të përgjithshme të së drejtës procedurale dhe materiale, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine,²⁶ përgjithësisht të etiketuara (në kllapa ose thonjëza), duke u shoqëruar gjithmonë me dhënien e kuptimit të termit/shprehjes përkatëse në gjuhën shqipe, pa krijuar konfuzion për përmbajtjen apo kuptimin e tyre. Në referimin e fjalëve me karakter teknik, kryesisht në referimin e konkluzioneve të akteve të ekspertimit, përdorimi i termave teknikë është i kufizuar, i shoqëruar me shpjegimin e tij ose kuptohet qartë nga konteksti i arsytimit.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyës apo denigrues.

Në arsytimin e vendimeve evidentohet zbatimi i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Në të gjitha vendimet gjyqësore rezultojnë përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (*ë dhe ç*). Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës dhe paragrafët apo nënndarjet e arsytimit të vendimit gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Gjyqtari përdor fjali me gjatësi mesatare dhe shpesh herë të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi pasi në çdo rast rezultojnë se mendimi është shprehur në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë, paragrafët dhe nënndarjet e arsytimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës. Vendimet janë të organizuar në nënndarje, të identifikuar me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e tyre, dhe brenda nënndarjeve, në paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë dhe vazhdimësisë së mendimit dhe shpesh identifikohen me fjali tematike.

Në vendimet përfundimtare burim vlerësimi gjyqtari pasqyron dhe merr në analizë në çdo rast elementët proceduralë si kompetenca, juridiksioni, të drejtat e palëve, njoftimi i tyre, trajtimin e kërkesave të palëve ndërgjyqëse gjatë procesit gjyqësor dhe vendimmarrjet respektive të gjykatës lidhur me to, pavarësisht se nga përmbajtja e vendimit, jo në çdo rast këto elementë kanë qenë të diskutueshme nga palët apo rrethanat e çështjes.

Në vendimet burim vlerësimi pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur pretendimet dhe prapësimet e palëve, të cilat merren në analizë nga gjyqtari në mënyrë të specifike në pjesën arsyetuese të vendimit. Po kështu, në shumicën e vendimeve të analizuara, evidentohet vendosja e plotë e tekstit të dispozitave ligjore të zbatueshme, por duke vijuar në pjesën e argumentimit ligjor të gjykatës, me analizën dhe zbrërthimin e dispozitave të cituara. Prezenca

²⁶Është e diskutueshme nëse përdorimi i fjalëve në latinisht e rrisin apo jo vlerën e një vendimi gjyqësor, duke qenë se konsiderohet si “gjuhë e vdekur”, ndërkohë që vetë jurisprudenca ndërkombëtare kryesisht ajo e GJEDNJ-së shumë terma juridikë i përdor në gjuhën e vjetër latine. Pavarësisht këtij diskutimi, nëse do të konsiderohej vlerë, ajo do të duhej gjithmonë të shoqërohej me kuptimin e saj në gjuhën shqipe me qëllim që ky parim apo institut të bëhej i kuptueshëm edhe nga mosnjohësit e ligjit

e këtyre elementëve, në disa raste në mënyrë tepër të detajuar, gjithsesi i jep qartësi elementëve procedurale të gjykimit ose vendimit, dhe nuk cenon koncizitetin e tij.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kryesore të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër. Pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Çështje, Ligj, Argumentim, Konkluzion*) apo CRAC (*Konkluzion, Ligj, Argumentim, Konkluzion*) etj., të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

- Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Gjyqtari {...} ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës i përmbahet, jo vetëm prezantimit të fakteve dhe identifikimit të ligjit të zbatueshëm por edhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjyqtari ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkruese-arsyetuese në nënndarje, të identifikuar më tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e secilës pjesë. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit e çështjes, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, përfaqësuesit e tyre, prezenca ose mungesa e tyre në seancë, objekti i shqyrtimit (*padisë ose kërkesës*), si dhe kërkimet përfundimtare të palëve.

Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë, të cilat janë të listuar formalisht me tituj, si: (i) Paraqitja e padisë dhe aspekte procedurale; (ii) Rrethanat e çështjes, faktet dhe provat; (iii) Pretendimet e palëve dhe (iv) Vlerësimi i Gjykatës:

- (i) Në pjesën e parë të titulluar përgjithësisht “*Paraqitja e padisë dhe aspekte procedurale*”, sikurse rezulton nga titulli parashtrohen aspekte procedurale që lidhen me juridiksionin, kompetencën, formimi i trupit gjykues, legjitimitimin aktiv e pasiv, interesin e ligjshëm apo edhe vendimmarrjet e ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit si p.sh. pakësimin e objekti të padisë. Në këtë pjesë, në shumicën e vendimeve burim vlerësimi gjyqtari ka marrë në analizë kryesisht këto elementë procedural të vlerësuar si parakushte për zhvillimin e një gjykimi të rregullt dhe nga një gjykatë e caktuar me ligj, duke dhënë argumente ligjore lidhur me to.
- (ii) Në pjesën e dytë të titulluar procedura “*Rrethanat e çështjes, faktet dhe provat*” gjyqtari përshkruan dhe analizon faktet thelbësore të çështjes, të integruara me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim së bashku me analizën e tyre, duke ndjekur kryesisht një rend kronologjik në paraqitjen e faktit, siç ka rezultuar i provuar në gjykim.
- (iii) Në pjesën e tretë të titulluar “*Pretendimet e palëve*”, e cila është prezentë kryesisht në vendimet me natyrë më komplekse, gjyqtari përshkruhen në mënyrë të përmbledhur dhe provat që secila prej tyre pretendon se i provon.
- (iv) Në pjesën e titulluar “*Vlerësimi i gjykatës*” ose “*Argumentimi dhe vlerësimi i gjykatës*” në shumicën e vendimeve burim vlerësimi, ligji i zbatueshëm, si ai me natyrë procedurale, ashtu edhe dispozitat e ligjit material të zbatueshëm, janë pjesë e integruar e analizës ligjore të gjykatës, duke u lokalizuar krahas argumenteve të gjykatës lidhur me elementë të zbatimit të tij. Në ndonjë rast, gjyqtari para arsyetimit ligjor, ka referuar dhe cituar në një nënndarje me vetë dispozitat e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, të cilat më pas integrohen në arsyetim.²⁷ Në një pjesë të vendimeve burim vlerësimi, gjyqtari ka ndjekur metodën IRAC,²⁸ duke shtruar, menjëherë pas përshkrimit të analizës së fakteve procedurale dhe thelbësore të çështjes, pyetjet/çështjet ligjore të vlerësuara thelbësore,²⁹ për zgjidhjen e çështjes konkrete dhe duke organizuar më pas analizën ligjore në drejtim të përgjigjes së këtyre pyetjeve.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, data e shpalljes së vendimit dhe nënshkrimi i gjyqtarit dhe sekretares gjyqësore. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejmë pasqyrim disponimi i gjykatës mbi çdo kërkim të objektit të padisë apo kërkesës (*pranimin apo rrëzimin e kërkesë padisë*), si edhe se kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi pasqyrohet e drejta e ankimit dhe afati i ushtrimit të saj. Konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile.

Në tërësi, nga pikëpamja e përmbajtjes, mënyra e të shkruarit të vendimeve është e qartë dhe e strukturuar mirë, gjithmonë sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit, parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e të gjitha palëve ndërgjyqëse,

²⁷Vendimi nr.8868, datë 27.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁸IRAC (*issue, rule, analysis, conclusion*) është akronim për termat çështja, rregullimi (ose ligji përkatës), analiza (ose arsyetimi) dhe konkluzioni (ose përfundimi), metodë e përdorur në hartimin e dokumenteve dhe raporteve të caktuara ligjore

²⁹Në çështjet e përfunduar me vendimin nr.8868, datë 27.12.2019 gjyqtari ka ngritur çështje/pyetje ligjore lidhur me shkakun ligjor të padisë dhe mënyrën e zgjidhjes së kontratës së punës, nëse kjo është me efekt të menjëhershëm ose jo, si dhe nëse shkakun i zgjidhjes së kontratës së punës është me shkaqe të arsyeshme ose jo; Në çështjen e përfunduar me vendimin nr.4538, datë 24.06.2019 gjyqtari ka ngritur pyetje/ çështje ligjore lidhur me shkakun ligjor të padisë për secilin prej kërkimeve dhe si përcaktohen saktësisht

në përputhje edhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese e cila mos pasqyrimin e pretendimeve të palëve e ka vlerësuar si cenim të të drejtës për akses në gjykatë dhe të drejtës për t'u dëgjuar, ligjin e zbatueshëm, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata (*shtrimi i çështjeve për zgjidhje sipas metodës IRAC*) duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese, përfundimet e arritura nga gjykata. Konstatohet që pjesët përbërëse të cituara më sipër të jenë vendosur me titujt përkatës në pjesën arsyetuese të vendimit, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta për përmbajtjen e vendimit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme.³⁰ Ndonëse nuk kërkohet shprehimisht në nenin 6 të KEDNJ-së, e drejta e një vendimi të arsyetuar bën pjesë në të drejtën e një gjykimi të drejtë, siç garantohet nga neni 6, pika 1 i KEDNJ-së dhe gjen zbatim si në çështjet civile ashtu dhe ato penale. GJEDNJ-ja është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t'u ankuar.³¹ Arsyetimi i vendimit duhet të tregojë zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballlet gjyqtari për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin të vendimit duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar.

- Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, i detajuar dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të nevojshëm në raport me faktin, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u analizuar në raport me aspektet procedurale të gjykimit. Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material. Evidentohet kujdesi i gjyqtarit në arsyetim për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes.

³⁰Neni 142 i Kushtetutës së RSH-së

³¹Vendimi i GJEDNJ, Çështja "Suominen kundër Finlandës", 24 korrik 2003, paragrafët 34-38, si dhe çështja Hadjanastassiou kundër Greqisë, dt. 16.12.1992, fq. 33

Gjithashtu, evidentohet se gjyqtari i kushton rëndësi analizës së instituteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme p.sh.:

- (i) *institutin e parashkrimit fitues me titull*, për të cilin sqaron se ka për qëllim të vendos norma të reja nga nevoja që të ketë stabilitet në marrëdhëniet pasurore (siguria juridike për gjendjen e krijuar) dhe kushtet që duhet të plotësohen për tu fituar një send me parashkrim fitues janë: 1) posedimi i sendit; 2) posedimi për një kohë të caktuar; 3) sendi të jetë i aftë për t'u fituar me anë të parashkrimit fitues; 4) fitimi i pronësisë të jetë bërë në bazë të një veprimi juridik; 5) fituesi i sendit të ketë qenë me mirëbesim. *Institutin e parashkrimit fitues pa titull*, i cili ka për qëllim të shmang situatat e paqarta, të pasigurta dhe ato konfuze, të krijuara lidhur me përkatësinë e pasurive dhe përcakton kushtet që duhet të plotësohen që të jemi përpara këtij instituti: 1) të jetë i paluajtshëm, i ndryshëm nga pasuria “pronë publike e paluajtshme e patjetërsueshme” dhe/ose nga ndonjë pasuri me regjim juridik të ngjashëm, me kufizime ligjore për të qenë e lirë në qarkullimin civil (Ligji nr. 8743/2001 se ndonjë ligj/legjislacion); 2) të ketë poseduar sendin në mënyrë të qetë e të pandërprerë për një periudhë 20 vjeçare; 3) të jetë sjellë me sendin njësoj sikur të ishte pronar i tij;³²
- (ii) *mjeteve të posaçme të mbrojtjes gjatë fazës së ekzekutimit* duke interpretuar dhe analizuar në mënyrë të thelluar nenin 610 të K.Pr.Civile lidhur me mjetin procedural “*Kundërshtimin e veprimeve përmbartimore*”, për të cilin mban qëndrimin se është gjykim themeli që përqendrohet mbi shqyrtimin e ligjshmërisë ose jo të veprimeve përmbartimore, kundërshtitë lidhen me formën e aktit procedural, me përmbajtjen e aktit procedural, me mosrealizimin e rregullt të njoftimeve; nuk lidhet me themelin e titullit ekzekutiv dhe në këtë aspekt bën dallimin se kjo arrihet përmes nenit 609 të K.Pr.Civile;³³
- (iii) *institutin juridik të dëmshpërblimit në rastet e zgjidhjes së marrëdhënies së punës*, duke analizuar kontrata e punës, kontrata individuale e punës, kontrata kolektive e punës dhe karakteristikat e saj, hierarkia dhe përparësia e normave të së drejtës në punë;³⁴
- (iv) *Institutin juridiko-civil të detyrimit*, duke analizuar kuptimin e detyrimit, lindjen e detyrimeve, afatin e ekzekutimit të detyrimit, mënyrën e ekzekutimit, vonesa e debitorit, fitimi i munguar, kontrata ka forcën e ligjit për palët, zgjidhja e kontratës.³⁵

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, në të gjitha vendimet burim vlerësimi ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsytimit me të cilën lidhet pretendimi (*me aspektet procedurale të gjykimit, marrjen e provave dhe mënyrën e marrjes së tyre, provueshmërinë e faktit apo përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes civile, etj.*) Duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar në përmbajtje të arsytimit ligjor dhe në disa raste komplekse në një pjesë të veçuar të arsytimit (*por në pjesën përkatëse të arsytimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret*), pretendimet e palëve gjithnjë kanë marrë një përgjigje të argumentuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsytimit tërësor.

³²Vendimi nr.4538, datë 24.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³³Vendimi nr.3597, datë 20.05.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³⁴Vendimi nr.8868, datë 27.12.2019i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³⁵Vendimi nr.1630, datë 05.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Në disa vendime gjyqësore argumenti rrjedh nga çështja apo pyetja ligjore e parashtruar nga ana e gjyqtarit për zgjidhje në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes dhe hap pas hapi evidentohet argumentimi në të cilin gjyqtari i përgjigjet çështjes me përfundimin ligjor. Ndërkohë në vendimet e tjera burim vlerësimi nuk është ndjekur kjo mënyrë, por edhe pse jo në mënyrë të shprehur (*ngritja e çështjes apo pyetjes ligjore në mënyrë eksplicite*), ajo vjen e nënkuptuar nga analiza dhe arritja e përfundimit ligjor, i cili në çdo rast vjen si konkluzion i analizës tërësore të çështjes.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsyetimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit, si dhe mbështetja e tij në qëndrimet e praktikës gjyqësore, duke pasuruar arsyetimin e vetë gjyqtarit. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, në shërbim të zgjidhjes së çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit {...} në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë

2.A.a Respektimi i afateve ligjore

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjithsej 33 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare” dhe “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”.

Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (19 çështje),³⁶ me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (33 çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 57.6% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtari parashtron se ka respektuar afatin e parashikuar në ligj për përfundimin e çështjes dhe në ato raste kur nuk është respektuar ky afat, kjo ka ardhur për shkaqe të pavarura prej tij. Kështu, gjyqtari parashtron se në çështjet me objekt “Kundërshtimin e veprimeve përmbarimore”, si gjykime të posaçme në fazën e ekzekutimit, shpesh në praktikë ndeshen vështirësi që nuk janë menduar dhe parashikuar nga ligjvënësi se mund të përsëriten kaq shpesh, si p.sh depozitimi i një ankimi sipas nenit 610 pa krijuar ndërgjyqësinë e duhur kreditor/debitor/përmbarues/dorëzanës dhe pa vënë në dispozicion të gjykatës dosjen e plotë të fazës përmbarimore, situata që e detyrojnë gjykatën të kryejë veprime kryesisht për këto mangësi dhe nevoja të kësaj kategorie të çështjeve, me pasojë direkt në mospërbushjen e këtij detyrimi për të përfunduar çështjen brenda afatit 20 ditor. Në disa raste, pikërisht, për këto shkaqe, nga ana e gjyqtarit është vlerësuar shqyrtimi i ankimit jo në dhomë këshillimi, por duke thirrur vetë të gjitha palët e procesit të ekzekutimit në një seancë gjyqësore, duke kërkuar dosjen e plotë përmbarimore, si dhe duke kërkuar shpjegime plotësuese për të qartësuar shkakun dhe motivin e kundërshtimit të veprimit përmbarimor, apo edhe duke marrë provë me ekspert nisur nga natyra e pretendimeve. Pra, janë kryer veprime procedurale në dobi të procesit për një hetimi gjyqësor të plotë e të gjithanshëm (neni 14) dhe për të garantuar një gjykim të drejtë duke thirrur e dëgjuar palët (nenet 18, 20 të Kodit). Gjyqtari përmend këtu disa nga çështjet që kanë përfunduar tej afateve ligjore për shkaqet e sipërcituara: - çështja me nr. vendimi 5770, datë vendimi 09.09.2019, me ankues Arben Peto etj.; - çështja me nr. vendimi 4959, datë vendimi 08.07.2019, me ankues Kastriot Strataj etj.; - çështja me nr. vendimi 783, datë vendimi 07.02.2019, me ankues OSHEE sha; - etj. Gjyqtari vlerëson se në të gjitha rastet shqyrtimi i çështjes ka përfunduar brenda afateve të përcaktuara nga ligji procedural (kërkesat/ankimet sipas neneve 202, 609, 610, 615/a të Kodit), përderisa nga ana e tij është disponuar dhe është dhënë vendimi menjëherë dhe sapo janë përbushur nevojat e rastit për dokumentacionin apo për ndërgjyqësinë, duke vlerësuar se kohëzgjatja tej afatit ligjor është thjesht kalim fizik i numrit të ditëve dhe është një kohëzgjatje artificiale, pasi përfshin edhe kohën kur janë kryer veprime procedurale të nevojshme dhe të domosdoshme për të garantuar një proces të rregullt ligjor.

Në lidhje me afatin e gjykimit në çështjet me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbarimore” neni 610 i K.Pr.Civile parashikon se ato shqyrtohen në dhomë këshillimi dhe kur e vlerëson të arsyeshme, gjykata mund të thërrasë palët. Pavarësisht mënyrës së shqyrtimit, në dhomë këshillimi apo në seancë, gjykatës i duhet të kryejë disa veprime procedurale për të respektuar të drejtat e palëve në proces, duke kryer të paktën veprimet e mëposhtme:

- njoftimin e ankuesit për të plotësuar të metat e ankimit, nëse konstatohen të tilla dhe lënien e një afati të arsyeshëm për plotësimin e të metave, sipas parashikimeve të nenit 154/a të K.Pr.Civile;
- njoftimin e ankimit dhe akteve shoqëruese përmbaruesit gjyqësor dhe lënien e një afati të arsyeshëm për të paraqitur aktet e dosjes përmbarimore (nëse ato nuk janë paraqitur të plota nga ankuesi) dhe për të parashtruar qëndrimin e tij lidhur me ankimin;

³⁶Çështjet të përfunduara jashtë afatit ligjor janë: Tabela nr.1-numër rendor 49, 60, 61, 71, 79, 81, 82, 92, 112, 119, 121, 126, 131 (me objekt kundërshtim veprimesh përmbarimore); Tabela nr.2-numër rendor 10, 16, 28, 59, 76 dhe 80 (me objekt marrje mase e përkohshme)

- caktimin e seancës dhe njoftimin e palëve për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit, duke respektuar një afat minimal për të mundësuar kryerjen e njoftimit prej 5 ditësh para seancës, nëse çështja do të shqyrtohet duke thirrur palët për t'u dëgjuar.

Vetëm me kryerjen e këtyre veprimeve minimale dhe të domosdoshme për të respektuar të drejtat e palëve në proces, si dhe për të mundësuar kryerjen e hetimit të plotë dhe gjithanshëm lidhur me çështjen, pa përllogaritur kohën e nevojshme për dërgimin e njoftimeve për plotësimin e të metave të padisë dhe për dërgimin e njoftimit për përmbaruesin gjyqësor për paraqitjen e prapësimeve dhe provave, afati ligjor 20 ditor i gjykimit do të rezultonte i tejkaluar. Ndërkohë që ligjvënësi, ndërsa për gjykatën e shkallës së parë që shqyrton ankimin në themel ka parashikuar afatin 20 ditor të shqyrtimit, për gjykatën e apelit që shqyrton ankimin ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, mbi shkaqet e ankimit dhe kryesisht duke u bazuar në aktet e dosjes, ka parashikuar në nenin 610 një afat më të gjatë gjykimi prej 30 ditësh ose 45 ditësh, në rast se gjykata vlerëson të nevojshëm shqyrtimin e çështjes me praninë e palëve, kur janë rastet e parashikuara nga ligji. Nëse për gjykimin në shkallë të parë do të zbatohet i njëjti afat, pra afati 30 ditë për shqyrtimin në dhomë këshillimi dhe 45 ditë për shqyrtimin në seancë, rezulton se për të 5 (pesë) çështjet afati i përfundimit të gjykimit nuk do të ishte tejkaluar pasi çështjet kanë përfunduar respektivisht për 43, 37, 39, 21 dhe 31 ditë. ***Për këto arsye, këto pesë çështje përllogariten si çështje që janë gjykuar brenda afatit ligjor.***

Në çështjet me objekt “Sigurim padie”, nga 11 çështje, 6 prej tyre janë gjykuar jashtë afatit ligjor 5 ditor dhe konkretisht kanë përfunduar për 8, 7, 18, 10, 8 dhe 10 ditë.³⁷ Nuk rezultojnë për këto çështje vonesa në shortimin e tyre, pasi rezulton se janë shortuar në të njëjtën datë me regjistrimin e tyre në gjykatë. Në këto 6/çështje afati i gjykimit 5/ditor rezulton të jetë tejkaluar nga 3 deri në 13 ditë.

Sa më sipër, numri i çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor të gjykimit, pas analizës si më sipër, rezulton të jetë 14 çështje të gjykuara jashtë afatit ligjor. Duke iu referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (14 çështje) me numrin e çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (33 çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 42% të çështjeve tej afatit ligjor.

Kjo përqindje e çështjeve jashtë afatit ligjor, sipas Metodologjisë pikëzohet me 3 (tre) pikë. Në Metodologji, lidhur më këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjitha burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në rastin konkret, pavarësisht numrit të ulët të çështjeve për të cilat ligji parashikon afate ligjore gjykimi, rezulton se gjyqtari ka pasur një ngarkesë të lartë çështjes në periudhën e vlerësimit prej 647 çështje, si dhe ka përfunduar 576 çështje.

KONKLuzioni

Duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, konkretisht:

- a) numrit të ulët të çështjeve të shqyrtuara, të cilat llogariten me afat ligjor (33 çështje), çka ndikon edhe raportin e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor me numrin e çështjeve për të

³⁷Tabela nr. 2, numrat rendorë 10, 16, 28, 59, 76 dhe 80

cilat ligji parashikon afat ligjor; (nga 33 çështje në total, 14 çështje, me **mesatare** tejkalimi 39 ditë për çështjet me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbarimore”);

b) fakti që në 5 çështje (me objekt kundërshtim veprimesh përmbarimore), koha e shqyrtimit të tyre është më e vogël se 45 ditë, brenda të cilës mund të përfundojë gjykimi i së njëjtës çështje në gjykatën e apelit. Ligji procedural parashikon për shkallën e parë shqyrtimin e ankimit ndaj veprimeve përmbarimore brenda 20 ditëve, si rregull në dhomë këshillimi. Gjykatës i njihet mundësia e thirrjes së palëve kur e vlerëson të nevojshme. Por ligji nuk parashikon afat për gjykatën e shkallës së parë, sikundër bën në rastin e gjykimit në apel, për shqyrtimin e çështjes kur ajo kalon në seancë gjyqësore. Kjo situatë ligjore nuk mund të anashkalohet nga vlerësuesi, në rastet kur afati i gjykimi i çështjeve të kësaj kategorie, në shkallën e parë, tejkalon afatin 20 ditor, por është më i shkurtër se 45 ditë (**sikurse ka ndodhur në çështjet me numër rendor 61, 82, 112, 126 dhe 131 të tabelës nr.1 ku pasqyrohen çështjet me palë kundërshtare, të cilat janë gjykuar përkatësisht për 43, 37, 39, 21 dhe 31 ditë, pra në më pak se 45 ditë**);

c) tejkalimin e afatit ligjor të gjykimit për 6 çështjet me objekt “Sigurim padie” me vetëm disa ditë; për këtë tregues gjyqtari pikëzohet më lart se niveli i pikëzimit që i përket përqindjes së çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit, pavarësisht se përqindja e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor rezulton 42%. Për pikëzimin e këtij treguesi, vlerësuesi bazohet në parimin e proporcionalitetit, objektivitetit, përballë detyrueshmërisë ligjore që një kategori çështjesh duhet të shqyrtohen brenda afateve të përcaktuara. Pavarësisht rrethanave konkrete që lidhen me kushtet e punës, numri relativisht i vogël i çështjeve me afat gjykimi (në total 33 nga të cilat 14 jashtë afatit) nuk justifikon një pikëzim maksimal, sepse gjyqtari duhej të kishte treguar një shkallë më të lartë kujdesi në shqyrtimin me përparësi të këtyre çështjeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar përqindjes së çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor dhe shkallës së përgjegjësisë së gjyqtarit, në lidhje me këtë tregues gjyqtari pikëzohet me 12 pikë.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjithsej 543 çështje për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, të cilat i përkasin kategorive të çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare” dhe “Marrëdhënie pune”, për të cilat vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010, i KLD përcakton këto standarde minimale kohore për gjykimin në gjykatën e shkallës së parë, si vijon:

- jo më tej se 6 muaj për gjykimet civile të themelit;
- jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave civile pa palë kundërshtare.

Referuar tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se nga **543** çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, **122**³⁸ prej tyre janë gjykuar tej këtij afati duke përbërë **22%** të çështjeve të gjykuara jashtë standardit minimal kohor në fuqi.

³⁸Tabela nr.1-numër rendor 1-34, 36, 37, 42, 44-46, 50, 52, 54, 58, 65, 70, 75, 77, 85, 86, 88, 89, 91, 95-97, 100, 108, 109, 115; Tabela nr.2-numër rendor 1, 3, 21, 26, 30, 31, 32, 37, 41, 51, 164, 239, 240, 249, 253, 254, 256, 257, 264, 267, 270, 273, 274, 281, 340, 347, 353-355, 358, 369-378, 380-383, 385-388; Tabela nr.7-numër rendor 1-6, 11-17 dhe 20

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtari dhe zëvendëskryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke parashtruar se *“Referuar të dhënave statistikore për çështjet për të cilat aplikohet standard minimal kohor për përfundimin e gjykimit, sipas Tabelës nr.1 dhe nr.7, rezulton edhe ndonjë çështje që është përfunduar përtej këtij standardi. P.sh, mund të evidentoj raste, kur gjykata duhet të ishte shprehur lidhur me një kërkesë të ngutshme për sigurimin e padisë dhe/ose pezullimin e gjykimit brenda afatit 5 ditor, në zbatim të neneve 202, 609, 610, 615/a të K.Pr.Civile, por që sipas të dhënave të dosjes kjo ka ndodhur, ngaqë unë si gjyqtar kam vlerësuar që mbi këtë kërkim të mos disponoj në dhomë këshillimi, por ta marr në shqyrtim në prezencë dhe duke dëgjuar palët në proces, dmth kam urdhëruar thirrjen e njoftimin e tyre në seancë, gjë që ka sjellë edhe tejkalimin e këtij afati ligjor. Gjithsesi, vënia në lëvizje është bërë brenda afatit 5 ditor të përcaktuar dhe distanca kohore ndërmjet seancave ka qenë po e tillë, madje është evidentuar edhe data e marrjes së dosjes nga ana ime. Kështu, përmend rastet:1) - çështja me nr.regj.themeltar 12339, dt.regj.them 25.09.2019, datë vendimi 15.10.2019, me paditës shoqëria “STEOLB H“ shpk; 2)- çështja me nr.regj.themeltar5012, dt.regj.them 11.01.2019, datë vendimi 29.01.2019, me paditës Islam Gërdeci; 3)- çështja me nr.regj.themeltar 5376, dt.regj.them 15.01.2019, datë vendimi 13.02.2019, me paditës shoqëria “TRING“ shpk; Mendoj se, pavarësisht këtyre fakteve e rrethanave që nuk janë kushtëzuar nga ana ime, si gjyqtar kam ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme organizative dhe janë kryer të gjitha veprimet e duhura procedurale, me qëllim zhvillimin e përfundimin e procesit në kohë, por kohëzgjatja e secilit gjykim është determinuar nga arsye që kanë të bëjnë me respektimin e normave procedurale sipas situatave të përmendura pak më sipër. Duke iu referuar këtyre rrethanave e shkaqeve, si dhe numrit të çështjeve që janë gjykuar tej standardit minimal kohor, këto për shkaqe tërësisht procedurale, vlerësoj se respektimi i standardeve minimale kohore në përfundimin e çështjeve ka qenë në nivel maksimal dhe në vëmendjen time të veçantë (shkaqet nuk janë përgjegjësi e imja si gjyqtar, por për shkaqe objektive që lidhen me ecurinë e procesit, respektimin e të drejtave të palëve, njoftimin e tyre etj.). Sipas opinionit tim, referuar dosjeve dhe procesve në vitin objekt vlerësimi (2019), angazhimi im si gjyqtar në përfundimin në kohë të çështjeve është maksimal, por ka qenë ecuria procedurale e tyre që ka kushtëzuar përfundimin e çështjeve tej standardit minimal”.*

Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 122 çështjet e shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, rezulton se në disa raste vonesa në shqyrtim ka ardhur si pasojë e lejes vjetore të kryer nga gjyqtari. Nëse në përlllogaritjen e afatit të gjykimit nuk do të përfshihej periudha kur gjyqtari ka qenë me leje vjetore, atëherë disa prej këtyre çështjeve do të kishin përfunduar brenda standardeve minimale kohor. Konkretisht:

Për kategorinë “Civile me palë kundërshtare”, rezulton se:

- çështjet me numër rendor 29, 89, 97, 100, 108, 109 dhe 115, (7 çështje) kanë përfunduar respektivisht për 214, 210, 208, 193, 210, 202 dhe 182 ditë. Duke hequr periudhën e lejes vjetore (35 ditë), këto çështje do të kishin përfunduar për 179, 175, 173, 158, 175, 167 dhe 147 ditë, pra brenda standardit minimal kohor 6 muaj (180 ditë) për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare; Po kështu edhe çështjet me numër rendor 26, 32, 77, 85 dhe 95 (5 çështje) gjykimi i të cilave ka përfunduar respektivisht për 222, 223, 219, 216 dhe 223 ditë. Duke hequr periudhën e lejes vjetore (35 ditë), këto çështje do të kishin përfunduar për 187, 188, 184, 181 dhe 188 ditë, pra duke e tejkaluar standardit minimal kohor 6 muaj (180 ditë) për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare me vetëm 8, 4, 1 dhe 8 ditë;

Për kategorinë “Civile pa palë kundërshtare”, rezulton se:

- çështjet me numër rendor 164, 232, 240, 249, 253, 254, 256, 257, 264, 267, 270, 273 dhe 281 (13 çështje), i janë caktuar gjyqtarit me short në muajin korrik 2019 dhe kanë përfunduar në muajin shtator të po atij viti, përkatësisht kanë përfunduar për 84, 78, 89, 91, 80, 72, 71, 69, 74, 71, 81, 81 dhe 69 ditë. Duke zbritur periudhën e lejes vjetore (35 ditë), të gjitha këto çështje do të kishin përfunduar brenda standardit minimal kohor 2 muaj (60 ditë) për gjykimin e çështjeve civile pa palë kundërshtare; Në këtë kategori çështjesh rezultojnë edhe çështjet me numër rendor 385, 386, 387 dhe 388 (4 çështje), të cilat kanë përfunduar respektivisht për 63, 63, 62 dhe 61 ditë, duke tejkaluar me vetëm 1 apo 3 ditë afatin standard prej 2 muaj ose 60 ditë;

Nëse në përlogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, do të përjashtoheshin 29 çështjet e analizuara më sipër, të cilat, nëse do të zbritet periudha e lejes vjetore, rezultojnë të përfunduara brenda afatit apo ky afat rezulton i tejkaluar me vetëm 1 deri në 8 ditë (i papërfillshëm). Bazuar në analizën e mësipërme rezulton se nga 543 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 93 prej tyre ose rreth **17% janë gjykuar jashtë standardit** minimal kohor në fuqi, i cili sipas Metodologjisë pikëzohet me 4 pikë.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me :

- a) raportit të çështjeve të gjykuara tej afatit standard, me numrin total të çështjeve për të cilat zbatohet ky afat, i cili rezulton të jetë në masën 17%;
- b) mendimin e zëvendëskryetarit dhe vetëvlerësimin e gjyqtarit lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve;
- c) treguesin sasior të punës gjatë periudhës së vlerësimit, ku rezulton se gjyqtari ka përfunduar 576 çështje, nga të cilat 158 çështje me palë kundërshtare;³⁹
- d) natyrën orientuese dhe jo detyruese të këtyre standardeve kohore;

pavarësisht përqindjes së mësipërme, për këtë tregues, gjyqtari pikëzohet me një nivel me të lartë pikëzimi, me 5 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit për treguesin “Plotësimi i standardeve minimale kohore” pikëzohet me 5 pikë.*

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar për shumicën e kategoritë e çështjeve. Konkretisht:

³⁹Në pikën 3 shkronja “h” të “Kritereve matëse të veprimtari së gjyqësore”, miratuar me vendimin e KLD nr.261/2 të vitit 2010, lidhur me Standardi sasior i punës parashikohet: **e. Gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator, i seksionit të përgjithshëm, jo me pak se 120 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare.**

- i. Në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 231 ditë, pra ***më e gjatë*** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj;
- ii. Në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 29.6 ditë , pra ***më e shkurtër*** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- iii. Në kategorinë e çështjeve “Marrëdhënie pune”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 236.4 ditë, pra ***më e gjatë*** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj;

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar shumë të lartë aftësinë e tij lidhur me këtë tregues, duke argumentuar se “Referuar të dhënave statistikore, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje në raport me standardet minimale kohore të shqyrtimit në fuqi (Vendimi nr.261//1 i KLD), rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më e shkurtër ose e barabartë me standardin minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve. Mendoj se, nisur nga natyra e secilës çështje dhe nga veprimtaria procedurale që kam kryer në vijimësi të secilit gjykim, kam treguar aftësi shumë të mira për të përfunduar çështjet në afat, sipas kategorisë përkatëse, në raport me standardet minimale kohore për çdonjërin kategori, gjë që është arritur duke bërë përpjekjet maksimale për të përmbushur këtë komponent profesional”.

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.⁴⁰ Referuar metodologjisë, duke qenë se nga 3 kategori çështjesh, 2 prej tyre koha mesatare tejkalon standardin minimal kohor, gjyqtari duhej të pikëzohej me 2 pikë. Por vlerësuesi merr parasysh në pikëzim situatën konkrete, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Nga analiza e të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është ***më e gjatë*** se standardi minimal kohor i miratuar 2 nga 3 kategoritë e çështjeve, duke u tejkaluar koha mesatare përkatësisht me 1 muaj e 21 ditë dhe 1 muaj e 26 ditë për secilën kategori. Duke analizuar këto kategori çështjesh rezulton se (i) për kategorinë “Civile me palë kundërshtare”, rezulton se nga 137 çështje, afati standard është tejkaluar për 60 prej tyre dhe (ii) për kategorinë “Marrëdhënie pune”, afati standard është tejkaluar për 14 nga 21 çështje.

Po ashtu, në pikëzimin e këtij treguesi, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit, siç është në rastin konkret, treguesi sasior i punës pasi rezulton se gjyqtari ka përfunduar këtë vit kalendarik në total 576 çështje, nga të cilat 158 çështje me palë kundërshtare, duke tejkaluar këtë standardin sasior në fuqi me 38 çështje në vit ose në masën 32%.

KONKLUZIONI

Në tërësi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, si dhe krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje për të gjitha

⁴⁰Metodologjia e Pikëzimit për këtë tregues parashikon se “Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal”.

kategoritë, me standardin minimal kohor në fuqi për kategori çështjesh, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më i gjatë se ky afat për 2 nga 3 kategoritë e çështjeve, duke u tejkalluar ky afat 51 dhe 56 ditë. Bazuar në të njëjtat argumente si për treguesin e “Plotësisimit të standardeve minimale kohore”, si dhe duke vlerësuar kategorinë e çështjeve për të cilat ky standard rezulton i tejkalluar, kohën e tejkallimit dhe natyrën e standardeve orientuese (jo detyruese), për këtë tregues gjyqtari, bazuar në analizën logjike të të dhënave statistikore, pikëzohet me dy nivele më të lartë se ai që rezulton nga analiza matematikore, duke e pikëzuar me 4 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit për treguesin “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje” pikëzohet me 4 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, për të gjithë periudhën e vlerësimit (01.01.2019-31.12.2019) si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (576 çështje) me numrin e çështjeve të caktuara (647 çështje) brenda vitit kalendarik, është **89%**. Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, treguesi i rendimentit 89% pikëzohet me 6 pikë.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari ka parashtruar se *nisur nga natyra dhe shumëllojshmëria e çështjeve që kam përfunduar në këtë vit gjyqësor apo që kam marrë në shqyrtim këtë vit dhe që mund të jenë mbartur, nisur nga numri i lartë i vendimeve të themelit që kam përfunduar, të dhënat statistikore tregojnë një rendiment të lartë të punës sime si gjyqtar në përfundimin e gjykimit të çështjeve. Mbi këto të dhëna kam treguar aftësi të larta në përfundimin e gjykimeve civile, kjo duke iu referuar raportit midis numrit të çështjeve të përfunduara në vështrim krahasues në po atë gjykatë për po këtë tregues (rendimenti i gjykatës dhe rendimenti i gjyqtarit) apo në vështrim krahasues me mesataren në RSH, pavarësisht kohës që mund të jetë dashur për përfundimin e çështjeve, sipas kategorive përkatëse. Në vijimësi, mendoj se, kam bërë përpjekjet maksimale në këtë aspekt, duke mos treguar neglizhencë në veprimtarinë e përditshme si gjyqtar.*

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, rendimenti llogaritet si raport mes numrit të çështjeve gjyqësore të përfunduara nga gjyqtari, pavarësisht kohës së caktimit të tyre, me numrin e çështjeve gjyqësore që i janë caktuar brenda një viti kalendarik. Për këtë arsye, numri i çështjeve të mbartura nga viti i mëparshëm, nuk ndikon në llogaritjen e rendimentit.

Por referuar përsëri të njëjtit akt nënligjor, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit, siç është në rastin konkret, treguesi sasior i punës së gjyqtarit. Kjo e fundit merret në konsideratë vetëm në rast se gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës, i përcaktuar në rastin konkret 120 çështje. Gjyqtari ka përfunduar këtë vit kalendarik në total 576 çështje, nga të cilat 158 çështje themeli, duke tejkalluar standardin sasior në masën 32%.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 89%, por ndërkohë rezulton se ai ka tejkaluar standardin sasior për çështjet e themelit të përfunduara me 32%, si dhe ka përfunduar një numër të konsiderueshëm çështjesh pa palë kundërshtare (418 çështje). Në analizë logjike të të dhënave statistikore dhe shkaqeve që kanë ndikuar në rendimentin e gjyqtarit, ato janë të tilla që lidhen me ngarkesën e punës gjatë periudhës së vlerësimit, ngarkesë e cila nga ana tjetër nuk e ka penguar gjyqtarin të tejkalojë standardin sasior në fuqi. Por ky tejkalim nuk rezulton mbi 50% të standardit sasior, pasi konstatohet se 418 çështje të shqyrtuara, janë kërkesa pa palë kundërshtare.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi se ai që përkon me rendimentin në masën 89%, duke u pikëzuar me 8 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh është si më poshtë:

- (i) Për çështje të kategorisë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsyetimit është 10.67 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;
- (ii) Për çështje të kategorisë “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare e arsyetimit është 5 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;
- (iii) Për çështje të kategorisë “Marrëdhënie pune”, koha mesatare e arsyetimit është 13.66 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor për të 3 (tre) kategoritë e çështjeve rezulton më shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, duke treguar shkallë të lartë të aftësisë dhe kujdes maksimal të gjyqtarit për arsyetimin e vendimeve në një kohë sa më të shpejtë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues pikëzohet me 15 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive

Referuar tabelave me të dhëna statistikore të dërguara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë evidentohet se në çështjet e përzgjedhura me short dhe të pasqyruara në tabelat përkatëse numri i seancave gjyqësore të zhvilluara për shqyrtimin e çështjes nuk përputhet me numrin e seancave të pasqyruar në kolonën “Nr. i seancave gjyqësore”. Konkretisht:

- Në tabelën nr. 1, çështja me numër rendor 18, ka të pasqyruar në kolonën e seancave gjyqësore 6 seanca, ndërkohë nga analiza e dosjes gjyqësore, me nr. 1630 vendimi, datë 05.03.2019, rezulton se numri i seancave gjyqësore është 5;
- Në tabelën nr. 1, çështja me numër rendor 31, ka të pasqyruar në kolonën e seancave gjyqësore 9 seanca, ndërkohë nga analiza e dosjes gjyqësore, me nr. 5169 vendimi, datë 15.07.2019, rezulton se numri i seancave gjyqësore është 5;
- Në tabelën nr. 1, çështja me numër rendor 89, ka të pasqyruar në kolonën e seancave gjyqësore 4 seanca, ndërkohë nga analiza e dosjes gjyqësore, me nr. 6871 vendimi, datë 17.10.2019, rezulton se numri i seancave gjyqësore është 3.

Nga informacioni i dërguar nga gjykata rezulton se në kolonën “Nr. i seancave gjyqësore” janë pasqyruar të gjitha seancat e zhvilluara për çdo çështje gjyqësore, duke përfshirë si seancat përgatitore, ashtu edhe ato gjyqësore. Sistemi me të cilin operon kjo gjykatë (ARK-IT) nuk mundëson evidentimin dhe ndarjen e seancave përgatitore, nga ato gjyqësore.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me treguesin “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive” përcaktohet se për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh.

Në kushtet kur në të dhënat e dërguara nga gjykata janë përfshirë jo vetëm seancat gjyqësore, por edhe seancat përgatitore, pasi këto të dhëna nuk gjenerohen në mënyrë elektronike në mënyrë të ndarë, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, *treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikave mundësohen në rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve, identifikohet dhe vlerësohet vetëm për çështjet e zgjedhura me short.*

Në mungesë të kësaj të dhëne, referimi do të bëhet ndaj 5 (pesë)⁴¹ nga 6 (gjashtë) çështjet e përzgjedhura me short, të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare” dhe “Marrëdhënie pune”. Rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për kategorinë “Civile me palë kundërshtare” është 3.5 seanca dhe për kategorinë “Marrëdhënie pune” është 7 seanca.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore, për të gjitha çështjet me palë kundërshtare të përzgjedhura me short për vlerësim, rezulton të jetë është **4.2 seanca gjyqësore**.

Gjyqtari në Formularin e Integruar të Vlerësimit, lidhur me këtë tregues ka parashtruar se ka treguar kujdesin e duhur për të shmangur seancat joproduktive, duke mbikëqyrur dërgimin e akteve procedurale palëve, dërgimin e njoftimeve ose shkresave lidhur me ndryshimin e

⁴¹Duke përfshirë çështjen me nr. 64 regjistri, datë regjistrimi 17.12.2018, për shkak se i përket kategorisë së çështjeve pa palë kundërshtare

objektit apo të shkakut ligjor, etj. Po ashtu, gjyqtari parashtron se në zbatimin real të parimit të kontradiktoritetit në gjykim, ka treguar kujdes kur palët kanë kërkuar kohë për debat gjyqësor mbi provat shkresore të palës tjetër dhe/ose ato të marra kryesisht nga ZVRPP/ISSH/ZGJC/ish-punëdhënësit në konfliktet e punës etj., apo në rastet e shqyrtimit të ekspertimit dhe/ose ekspertimit plotësues si provë, apo në paraqitjen e kontestimeve ligjore ndaj njëra-tjetrës, gjithmonë në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, për realizimin e të cilit duhet të gjendet rruga e duhur për të mos cenuar të drejtat e palëve që kërkojnë kohë në raport me detyrimin për të respektuar përfundimin e çështjes në një afat të arsyeshëm (*raporti midis neneve 3, 4, 14, 17, 18, 19, 20, 29 dhe 28 të Kodit të Procedurës Civile*). Gjithashtu, evidenton se në çdo rast kur nuk është bërë e mundur shmangia e seancave joproduktive, kjo ka ndodhur dhe është diktuar vetëm nga shkaqe tërësisht procedurale, si p.sh: - shtyrje e seancës për shkak të mosrealizimit të njoftimeve në mënyrë të rregullt të palëve; - shtyrje e seancës me synimin për të garantuar të drejtën e mbrojtjes, gjithnjë duke e paralajmëruar palën që të marrë masat të mos zvarrisë procesin; - shtyrja e seancës mbi kërkesën e palëve për të mos u zhvilluar, duke treguar vëmendje që këto të mos përsëriten mbi të njëjtin shkak dhe po ato palë, qoftë për mosprezencën në seancë, qoftë për shkaqe të tjera; etj.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short evidentohet se gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Konstatohet nga aktet në dosjet burim vlerësimi se gjyqtari për çdo çështje ka disponuar me urdhër për caktimin e datës së shqyrtimit të çështjes (*urdhër kalim në seancë gjyqësore, pas ezaurimit të veprimeve përgatitore*), duke caktuar seancën e parë gjyqësore dhe duke pasqyruar në këtë akt urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse, sipas kritereve të parashikuara në K.Pr.Civile.

Seancat përgjithësisht janë shtyrë për shkaqe të ndryshme procedurale të tilla si: *kalimin e çështjes në seancë gjyqësore; për të urdhëruar palën ndërgjyqëse të paraqes provën; njoftimin e ekspertit të caktuar për të bërë betimin dhe marrë detyrat; dhënien kohë ekspertit për të përgatitur aktin e ekspertimit; dhënien kohë palës paditëse për t'u njohur me aktin e ekspertimit; për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim nga palët; për të shpallur gjykata vendimin përfundimtar*. Rezulton se vetëm në dy raste shkak për shtyrjen e seancës gjyqësore është bërë mungesa e gjyqtarit, por për shkaqe të justifikuarra (*pjesëmarrja në Konferencën Gjyqësore për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor si dhe për shkak të një fatkeqësie familjare*).

Gjithashtu, konstatohet se seancat gjyqësore janë shtyrë brenda një afati në maksimum prej 20-30 ditësh nga njëra-tjetra. Vetëm në disa raste konstatohet lënia në një kohë të gjatë e seancës, për shkak të lejes vjetore në muajin gusht, apo në fund të vitit, periudhë kjo që përkon me procedurën e mbartjes së dosjeve nga administrata.

Pra, në tërësi, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjyqtarit së çështjes, si dhe për të kryer veprimet e nevojshme procedurale me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtave procedurale të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 4.2 seanca por nga ana tjetër gjyqtari në çdo rast ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet, prandaj gjyqtari lidhur me këtë tregues vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-productive” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi edhe pse numri mesatar i seancave gjyqësore për shumicën e kategorive të çështjeve, është më i lartë se 3 seanca, gjyqtari ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme procedurale dhe ka marrë çdo masë për të siguruar zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të gjykimit në dosjet e vëzhguara.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe/ose gjyqësore pas caktimit të çështjes me short, duke iu referuar rregullave dhe gjykimit sipas kategorive të çështjeve. Konkretisht, gjyqtari është shprehur me vendim, si për njoftimin e akteve dhe kërkesës padisë palëve të paditura konform nenit 158 të K.Pr.Civile në funksion të lëshimit të deklaratës së mbrojtjes, ashtu edhe për kalimin e çështjes në seancë përgatitore (neni 158/b i K.Pr.Civile) e në vijim, pas ezaurimit të seancës përgatitore edhe për nxjerrjen e urdhrimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore (neni 158/ç i K.Pr.Civile).

Gjatë gjykimit gjyqtari tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, legjitimitimin e përfaqësuesve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqet e mosparaqitjes së palëve ose të pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të paditurve, shpalljen e trupit gjykues, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore, duke pasqyruar shkakun në çdo rast, si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.).

Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosjet e vëzhguara, përgjithësisht, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, por ndeshen disa vonesa të cilat variojnë maksimalisht deri në 15 minuta (vonesa të

papërfillshme) të cilat lidhen me organizimin dhe përgatitjen e sallës për gjykim ose të diktuar nga kohëzgjatja e seancës pararendëse.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, janë mbajtur me regjistrim audio, si dhe janë dokumentuar me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efikasitet dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se aktet e dosjes janë të renditura në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve në dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj. Në rastin konkret, renditja sipas llojit të akteve procedurale, e ndërthurur edhe me veprimet procedurale të kryera nga gjyqtari gjatë gjykimit, është dhe konsiderohet si një mënyrë që e bën të lehtë dhe të shfrytëzueshme dosjen. Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (*njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave*). Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjyqimit. Në çdo dosje administrohen aktet shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse (*kërkesëpatria, provat, kërkesat dhe konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim*), aktet e hartuara nga gjykata (*vendimi për kalimin e çështjes në seancë përgatitore, komunikimet shkresore me të tretët, urdhri për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore, vendimet e ndërmjetme të arsyetuara, vendimet gjyqësore përfundimtare*).

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues. Në dosjet e vëzhguara nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
94	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me të dhënat që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarit u konstatuan këto të dhëna:

Sa i përket ankesave, referuar informacionit të përcjellë prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr.2102/1 prot., datë 04.07.2023, rezulton se ndaj gjyqtarit {...} në periudhën e vlerësimit, viti 2019 nuk rezulton të jenë paraqitur ankesa.

Gjyqtari dhe zëvendëskryetari i gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit i kanë vlerësuar shumë të larta aftësitë e gjyqtarit në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtarit

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, për gjyqtarin {...} nuk është paraqitur asnjë ankesë, gjithashtu sa i takon masave disiplinore, rezulton se për periudhën 01.01.2019- 31.12.2019, për gjyqtarin {...}, nuk është dhënë asnjë e tillë.

Nga raporti i ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 89/23 prot.. datë 15.05.2023, konkludohet se: *deklarimi i pasurisë është i saktë në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Gjyqtari dhe zëvendëskryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtarit në nivel shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjtetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim, apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtarit, gjyqtari pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjtetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtarit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se për periudhën 01 janar 2019–31 Dhjetor 2019, për gjyqtarin {...} janë paraqitur 3 (tre) kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit, të cilat janë rrëzuar të gjitha. Nga ana tjetër, rezulton se vetë gjyqtari ka paraqitur 2 (dy) kërkesa për heqje dorë, të cilat janë pranuar.

KONKLUZIONI

Sa më sipër, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është “I pakonsiderueshëm”, duke qenë se gjatë kësaj periudhe vlerësimi, nuk ka asnjë kërkesë të pranuar për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, ky numër vlerësohet “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit ne drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtari, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent, i kuptueshëm. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. I njëjti konstatim rezulton edhe nga aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, përfshirë këtu edhe regjistrimet e seancave në sistemin audio.

Gjyqtari dhe zëvendëskryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtarit në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparent me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk evidentohet asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo të subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “E lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtari dhe zëvendëskryetari i gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të tij me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale dhe përfshirjen në diskutime ligjore.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtari dhe zëvendëskryetari i gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar se gjyqtari ka patur një qasje bashkëpunuese dhe ndërvepruese gjithnjë në funksion të veprimtarisë gjyqësore.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtari për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 - 31.12.2019 ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësuesit dhe pjesëmarrësit.⁴²

Konkretisht evidentohet se gjyqtari {...}, përgjatë vitit kalendarik 2019, ka marrë pjesë në 13 (trembëdhjetë) aktivitete trajnuese si pjesëmarrës dhe në 1 (një) aktivitet trajnues si lehtësues, konvertuar në numër ditësh 26.5 ditë,⁴³ kohëzgjatje kjo që është brenda kufijve të parashikuar nga 5 deri në 40 ditë në vit, në periudhën një vjeçare të vlerësimit. Për periudhën e vlerësimit nuk rezulton që gjyqtari të ketë marrë pjesë në aktivitetet profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

⁴²Shkresa me nr. 494/11 prot, datë 05.07.2023 e Shkollës së Magjistraturës

⁴³Rregullorja e Brendshme e Shkollës së Magjistraturës në pikën 9 të nenin 55 të saj, parashikon : Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë: 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim; 1 ditë pjesëmarrjeje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim; 1 ditë pjesëmarrjeje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile, gjithsej 14 aktivitete të zhvilluara për 26.5 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 5 deri në 40 ditë në vit, në periudhën një vjeçare të vlerësimit.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, pikëzohet me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe dosjes personale të gjyqtarit {...}, evidentohen të dhëna në lidhje me këtë tregues si më poshtë vijon:

Referuar dosjes personale të gjyqtarit subjekt vlerësimi rezulton se me vendimin nr.37, datë 28.02.2019 “Për praktikën profesionale të kandidatëve për magistratë të Shkollës së Magjistraturës” rezulton se gjyqtari {...} është miratuar si magistrat gjyqtar udhëheqës për periudhën 2017-2020.

Referuar informacionit të përcjellë prej Shkollës së Magjistraturës, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë me cilësinë e lehtësuesit për trajnimin e gjyqtarëve në trajnimin me temë “Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Risitë e Kodit të Procedurës Civile. Trajtimi integral i dispozitave të Kodit të Procedurës Civile që rregullojnë ekzekutimin e detyrueshëm. Urdhri i ekzekutimit; Pavlefshmëria e titullit ekzekutiv; Kundërshtimi i veprimeve përmbartimore; Pezullimi i ekzekutimit të titujve ekzekutivë; Standardet ndërkombëtare dhe praktika gjyqësore shqiptare; Kontrolli gjyqësor mbi ekzekutimet; Aplikimi për rastet e procedurave përmbartimore për ekzekutimin e kontratave të kredive bankare; Veçimi i pjesës së debitorit bashkëpronar në fazën e ekzekutimit të detyrimeve dhe problemet e lindura në praktikën gjyqësore”, trajnim i zhvilluar në datat 6-7 mars 2019 (prezent në të dyja ditët e trajnimit, lehtësues).

Referuar vlerësimit të gjyqtarit, në formularin e integruar të vlerësimit gjyqtari ka deklaruar se në periudhën 2018-2020 ka udhëhequr disa kandidatë, kur në vitin 2019 evidenton magistratët K.K., S.L., secilën në periudha 4-mujore.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur më këtë tregues, përcaktohet se pikëzimi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë të tjera iu shtohen në vlerësim gjyqtarëve që e kryejnë këtë veprimtari njëkohësisht me veprimtarinë gjyqësore, pavarësisht nga frekuenca e angazhimit.

KONKLUZIONI

Sa më sipër, për gjyqtarin {...} duke qenë se gjatë periudhës së vlerësimit ka qenë lehtësues në trajnimin e gjyqtarëve pranë Shkollës së Magjistraturës, si dhe me vendimin nr.37, datë 28.02.2019 “Për praktikën profesionale të kandidatëve për magistratë të Shkollës së

Magjistraturës” është miratuar si magjistrat gjyqtar udhëheqës për periudhën 2017-2020, duke iu caktuar edhe gjyqtarë për mentorim për vitin 2019, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, pikëzohet me 5 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezultojnë të dhëna për vitin 2019 nga dosja personale e gjyqtarit në lidhje me pjesëmarrjen e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Në formularin e integruar gjyqtari ka parashtruar se ka marrë pjesë në ato aktivitete ku është ftuar për të dhënë mendime e opinione lidhur me miradministrimin e drejtësisë, të cilat, shpesh përfshinin vetëm drejtuesit e gjykatave dhe jo të gjithë trupën gjyqësore. Gjithashtu, parashtron se angazhimi i tij nuk ka munguar dhe nuk ka pasur raste të refuzimit të ftesa të caktuara, ku është sugjeruar për të marrë pjesë. Në mbështetje të vetëvlerësimit gjyqtari nuk ka paraqitur dokumentet përkatëse për të vërtetuar jo vetëm pjesëmarrjen e tij në këto aktivitete, por edhe kontributi i tij në këto veprimtari.

KONKLuzioni

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin {...}, ky tregues pikëzohet me 3 pikë, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna konkrete në drejtim të tij.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues pikëzohet me 3 pikë, duke qenë se nuk rezulton angazhimi i tij në aktivitete të kësaj natyre.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk evidentohen të dhëna për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 - 31.12.2019.

KONKLuzioni

Për sa më sipër, në mungesë të të dhënave për këtë tregues, gjyqtari pikëzohet me 0 (zero) pikë.

Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për treguesin “Publikimet ligjore akademike”, gjyqtari pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
93	Shkëlqyeshëm

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	94	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
Nivelin e përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	387	Shkëlqyeshëm

PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtari {...} të vazhdojë të mbajë në konsideratë angazhimin e tij në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit të tij për përmirësimin e sistemit gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARIN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2019 - 31 DHJETOR 2019

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Treguesit		Burimet	Shkalla e aftësisë
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
B. Arsytimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Tregues	Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
---------	---------	---------------------------------------

A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	11-20 %
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Mbi 93-99 %
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve
B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë

		kryetarit	
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë
B. Integriteti i gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë
C. Paanësia e gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i	I pa konsiderueshëm

kryetarit

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

	Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë
C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtari	5-40 ditë (Periudha 1/vjeçare)
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Ka të dhëna
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i	Nuk ka të dhëna

	sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit	
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të tij	Nuk ka të dhëna
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT		SHKËL	

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARIN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2019 - 31 DHJETOR 2019

3. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT			Pikët total		Niveli i vlerësimit
			100		Shkëlqyeshëm
Treguesit		Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë
C. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
D. Arsytimi ligjor	d. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë

	e. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	f. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
4. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				94	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
D. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	e. Respektimi i afateve ligjore	4. Të dhënat statistikore 5. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 6. Mendimi përfundimtar i kryetarit	11-20 %	12	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	f. Plotësimi i standardeve minimale kohore	4. Të dhënat statistikore 5. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 6. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %	5	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë

	g. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	4. Të dhënat statistikore 5. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 6. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve	4	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	4. Të dhënat statistikore 5. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 6. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Mbi 93-99 %	8	Tej standardit : Nën 81 % - 2 pikë Mbi 81-87 % - 4 pikë Mbi 87- 93 % - 6 pikë Mbi 93-99 % - 8 pikë +99% - 10 pikë
	h. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	4. Të dhënat statistikore 5. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 6. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15	Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural

					për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
E. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore	c. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	4. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 5. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 6. Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	d. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 5. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 6. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
F. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	c. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 4. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	d. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 5. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
6. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit

				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
D. Etika në punë	b. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	5. Informacioni i marrë nga ILD 6. Dosja personale e gjyqtarit 7. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 8. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
E. Integriteti i gjyqtarit	b. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	5. Informacioni i marrë nga ILD 6. Dosja personale e gjyqtarit 7. Mendimi përfundimtar i kryetarit 8. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtarit : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
F. Paanësia e gjyqtarit	c. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë

	d. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	5. Të dhënat statistikore 6. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 7. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
8. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				93	Shkëlqyeshëm
	Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
D. Aftësia e komunikimit	c. Komunikimi i qartë dhe transparent	5. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 6. Mendimi përfundimtar i kryetarit 7. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 8. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparencja e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	d. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	5. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 6. Mendimi përfundimtar i kryetarit 7. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 8. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
E. Aftësia për të	c. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit:

bashkëpunuar	me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave			E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	d. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
F. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	d. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	4. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 5. Dosja personale e gjyqtarit 6. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtari	5-40 ditë (Periudha 1/vjeçare)	20	Pjesëmarrja e gjyqtarit: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	e. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	3. Dosja personale e gjyqtarit 4. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	f. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	5. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 6. Mendimi përfundimtar i kryetarit 7. Dosja personale e gjyqtarit 8. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë

	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të tij	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
SIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT		387			
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT		SHKËLQYESHËM			

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

